



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRIŠTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/09/22

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga pala E.B, ndaj gjyqtarit P.Z, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 31.01.2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar nga E.B ndaj gjyqtarit P.Z, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Pala E.B ka ushtruar ankesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit P.Z, e cila është pranuar në kompetencë nga Autoriteti i Gjykatës Themelore në Prishtinë me datë 24.01.2022. Me datë 27.01.2022 është njoftuar Këshilli Gjyqësor për pranimin e ankesës.

Parashtruesi i ankesës E.B ka paraqitur ankesë ndaj gjyqtarit P.Z për shkak të pretendimeve se në aktgjykimin C.nr.2854/20, me të cilin është refuzuar si e pabazuar padia e paditësit, nuk janë shqyrtuar asnjë nga provat e propozuara nga paditësi ndërsa ka pranuar provat nga pala e paditur edhe pse ato nuk janë propozuar si prova në seancën përgatitore. Tutje, sipas parashtruesit të ankesës, gjyqtari ka shkelur detyrimet e tij, sepse nuk ka shqyrtuar secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku në bazë të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe rrjedhimisht kemi vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Në lidhje me pretendimet e paraqitësit të ankesës, gjyqtari i çështjes ka deklaruar se, për lëndën në fjalë, ka nxjerr aktgjykim me të cilin është refuzuar kërkesëpadia e paditësit për arsye të paraqitura si në aktgjykim, kundër aktgjykimit palët kanë të drejtë ankese në afatin e përcaktuar nga ligji. Tutje, gjyqtari i çështjes ka theksuar se, pretendimet e palës ankuese për aplikimin e gabuar të së drejtës materiale apo procedurale dhe mos vërtetim të gabuar dhe jo të saktë të gjendjes faktike nga ana e gjyqtarit mund të jetë shkak për ushtrimin e ankesës nga pala e pakënaqur në instancën e gjykatës më të lartë.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, deklarimit të gjyqtarit dhe pretendimeve të parashtruesit të ankesës, ka

vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit P.Z.

Autoriteti i kësaj Gjykate bazuar në faktet e çështjes ka gjetur se, nuk ka baza të arsyeshme për inicimin e hetimeve për shkelje disiplinore në veprimet e gjyqtarit P.Z, lidhur me aktgjykimin e marrë, për të cilin pala është ankuar.

Lidhur me pretendimin e palës ankuese, se gjyqtari P.Z ka qenë i njëanshëm në veprimet e tij gjatë procedurës gjyqësore, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate nuk ka gjetur bazë të mjaftueshme për t'i vërtetuar pretendimet e ushtruesit të ankesës, dhe për këtë vlerëson se nuk është shkelur parimi i pavarësisë dhe paanësisë të përcaktuar me dispozitën e nenit 5, par.2, nën-paragrafi 2.1 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Për aplikimin e gabuar të së drejtës materiale apo procedurale nga ana e gjyqtarit/ve gjatë punës së tyre, mund të jetë shkak për ushtrimin mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme në gjykatat e instancave më të larta nga pala e pakënaqur por nuk mund të konsiderohet shkelje disiplinore.

Në lidhje me aktgjykimin e marrë, Autoriteti i kësaj gjykate vë në pah se nuk ka të drejtën e komentimit apo ndryshimin e vendimit të marr nga gjykata përkatësisht nga gjyqtari, sepse për mënyrën e vendosjes së çështjes, gjyqtari vepron konform ligjit, në bazë të bindjes së lirë, pa asnjë presion apo ndikim nga kushdo qoftë, bazuar në provat/shkresat e lëndës, të thënat e palëve në procedurë si dhe legjislacionit në fuqi.

Andaj, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkuara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të Rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/09/22, me datë 31.01.2022

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë